

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më dt.	20.01.2023
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-45/A



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000

Prizren, Republika e Kosovës

**UDHËZUES PËR RISHIKIMIN E PROGRAMEVE
STUDIMORE NË UNIVERSITETIN "UKSHIN HOTI"
PRIZREN**

Prizren, 2023



**UDHËZUES PËR RISHIKIMIN E BRENDSHËM TË PROGRAMEVE
STUDIMORE NË UNIVERSITETIN ‘UKSHIN HOTI’ PRIZREN.**

Ky Udhëzues do t’u shërbejë njësive akademie dhe strukturave të tjera udhëheqëse të Universitetit, me rastin e akreditimit, rishikimit dhe ri-akreditimit të programeve studimore.



PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	4
2. RISHIKIMI PERIODIK I PROGRAMEVE EKZISTUESE STUDIMORE	5
3. KRITERET DHE PROCEDURA E RISHIKIMIT.....	6
3.1. Koha e realizimit të vlerësimeve.....	7
3.2. Procedura e rishikimit.....	7
4. PROCESI I AKREDITIMIT DHE RI-AKREDITIMIT.....	9
4.1. Aplikimi për programe të reja studimore.....	9
4.2. Procedura e hartimit të programeve të reja studimore.....	9
4.3. Procedura e aplikimit për riakreditim.....	10



1. HYRJE

Në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren (UUHP), programet studimore i nënshtrohen procesit të rishikimit të vazhdueshëm, si një pjesë kyqe e mekanizmave për sigurimin e cilësisë. Rishikimi i programeve bëhet nga vetë Universiteti, për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm periodik të programeve studimore. Po ashtu, programet studimore i nënshtrohen vlerësimit të jashtëm nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) me rastin e akreditimit dhe ri-akreditimit të programeve studimore në UUHP. Udhëzuesi përshkruan procesin e rishikimit të brendshëm të programeve studimore për akreditimin, rishikimin dhe ri akreditimin, me fokusi shpjegimin e kriterëve dhe procedurave të rishikimit të programeve studimore të cilat janë në zbatim.

Me qëllim të arritjes së objektivave të përgjithshme, nevojave të studentëve dhe të shoqërisë, UUHP bën monitorim dhe rishikimin e programeve studimore të cilat duhet të sjellin përmirësimin e vazhdueshëm të programit. Gjatë procesit të rishikimit të merren parasysh indikatorë të ndryshëm të cilët do të ndihmojnë për një vlerësim më të saktë të pikave të forta dhe të dobëta të programit studimor. Këto të dhëna do përdoren për përsosmërinë e programit dhe arritjen e objektivave të tij. UUHP ka paraparë procedura për hartimin dhe për rishikimin e programeve, të bazuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën të Kualifikimeve Evropiane për Arsimin e Lartë, Standardet e AKA-së për akreditimin e programeve studimore dhe dokumentet e brendshme Instrukionale.



2. RISHIKIMI PERIODIK I PROGRAMEVE EKZISTUESE STUDIMORE

Programet studimore në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren, i nënshtrohen procesit të vazhdueshëm të rishikimit. Në UHHP secila njësi akademike është përgjegjëse për të siguruar përmirësimin e cilësisë për programet studimore përkatëse.

Qëllimi i rishikimit në UUHP është të kontribuojë në vazhdimësi në rritjen e cilësisë së ofertave për programet studimore të cilat i ofron Institucioni. Monitorimi dhe rishikimi i rregullt i programeve studimore synojnë të garantojnë programe adekuate, dhe mjedis mësimor mbështetës dhe efektiv për studentët.

Ato përfshijnë vlerësimin e:

- Përmbytjes së programit në dritën e hulumtimit më të fundit në disiplinën e dhënë, duke siguruar kështu që programi është i përditësuar;
- Ndryshimin e nevojave të shoqërisë;
- Ngarkesën mësimore, progresin dhe kompletimin e studentëve;
- Efektshmërinë e procedurave të vlerësimit për studentët;
- Pritshmëritë, nevojat dhe kënaqshmërinë e studentëve në lidhje me programin;
- Mjedisin mësimor dhe shërbimet mbështetëse dhe përputhshmërinë e tyre për qëllimet e programit¹

Programet vlerësohen dhe rishikohen rregullisht duke i përfshirë studentët dhe palët e interesuara. Informacionet i mbledhura analizohen dhe programi përshtatet për të garantuar që ai është i përditësuar.²

¹ . ‘Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (SUE) Miratuar nga Grupi Përcjellës i Bolonjës në shtator 2014.Për miratim në Konferencën Ministrore në maj 2014-2015, Përkthyer nga Agjencia e Kosovës për Akreditim - AKA fq. 20. (https://akreditimi.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/06/ESG-in-Albanian_by-KAA.pdf)

² Po aty.



3. KRITERET DHE PROCEDURA E RISHIKIMIT

Rishikimi i programeve ekzistuese studimore në UUHP bëhet duke zbatuar kriteret e sigurimit të cilësisë të përcaktuara me Rregullore për Sigurimin e Cilësisë. Rishikimi i programeve studimore zbatohet një (1) një herë në vit

Gjatë procesit të rishikimit të programit ekzistues të studimit, duhet të merren në shqyrtim:

1. Treguesit Kryesor të Performancës (TKP);
2. Rezultatet e vlerësimit të programit studimor nga të diplomuarit;
3. Rezultatet e vlerësimit të diplomuarve nga punëdhënësit;
4. Rezultatet e vlerësimit të shkallës së punësimit të diplomuarve;
5. Konsultimi me Bordin Këshillues Industrial (BKI);
6. Raporti i zbatimit të rekomandimeve të grupit të ekspertëve ndërkombëtar;
7. Vlerësimi i lëndës;
8. Vlerësimi i mësimdhënësit dhe asistentit;
9. Plani strategjik i njësisë akademike;
10. Instrumenteve tjera të cilësisë.

Rezultat i procesit të vlerësimit të programit ekzistues mund të jetë plotësimi/ndryshimi, shkrirja dhe shuarja.

Njësitë akademike përmes Komisionit për Sigurimin të Cilësisë në nivel të fakultetit, në koordinim me Zyrën për Sigurimin e Cilësisë dhe Komisionin Qendror të Sigurimit të Cilësisë, udhëheqin procesin e sigurimit të cilësisë në programet studimore.

Raporti i rishikimit të programit studimor propozohet dhe miratohet në Këshillin e fakultetit. Në rast të ndryshimit/plotësimit të programit, të njëjtat duhet të marrin miratimin e Senatit.



3.1. Koha e realizimit të vlerësimeve

Vlerësimi dhe monitorimi për përmbushjen e standardeve të programeve, realizohet në bazë të planit vjetor të aktiviteteve të sigurimit të cilësisë.

Komisioni për Sigurimin e Cilësisë në nivel të fakultetit është i obliguar që të përcjellin zbatimin e standardeve të cilësisë së programeve dhe të zbatojnë anketa, analiza dhe raporte të cilat i propozojnë për shqyrtim të mëtutjeshëm Komisionit Qendror për Sigurimin e Cilësisë.

Strukturat e sigurimit të cilësisë në nivel të fakultetit, pas shqyrtimit dhe analizës së të dhënave, i propozojnë masat për përmirësimin e cilësisë së programeve studimore.

Vlerësimi i përgjithshëm, i përcaktuar, bëhet në fund të vitit kalendarik.

3.2. Procedura e rishikimit

Hapi 1: Komisioni për Sigurimi të Cilësisë në nivel të fakultetit, në bashkëpunim me Komisionin për Sigurimin e Cilësisë në nivel të Universitetit, gjatë muajit Janar, mbledhin dhe gjenerojnë të dhënat si dhe rezultatet nga pyetësi i vlerësimit të syllabusit, rezultatet nga pyetësi A.6 për programet studimore, pyetësi A8 për vlerësimin e programit nga të diplomuarit, dhe raportin vjetor për TKP-të. Raporti vjetor, së bashku me rekomandimet nga strukturat e cilësisë, dorëzohen në njësinë akademike.

Hapi 2: Dekani i njësisë akademike, në javën e parë të muajit Mars inicion rishikimin vjetor të programit të studimeve, duke i përfshirë përgjegjësit e programeve të studimit.


Hapi 3: Përgjegjësit e programeve, analizojnë të dhënat nga rezultatet nga raporti vjetor i vlerësimit të programit si dhe raportin e përmirësimit nga procesi i vlerësimit të jashtëm. Gjatë kësaj faze merren rekomandime nga studentët, nga Bordi Këshilldhënës Industrial i njësisë akademike. Rishikimi i programit bëhet në harmoni me procesin e rishikimit periodik të Syllabuseve, siç parashihen me Udhëzuesin për Hartimin dhe Rishikimin e Syllabusit në Universitet. Udhëheqësi/ja i/e sektorit për zhvillim akademik në Universitet, siguron mbështetjen administrative në procesin e rishikimit të programit të studimeve.

Hapi 4: Përgjegjësit e programeve përpilojnë një raport ku përfshihet shkalla e zbatimit të rekomandimeve nga vlerësimi i fundit i jashtëm deri në atë kohë, përputhshmërnë me standardet e AKA- së për akreditim, si dhe fokusi të TKP-të dhe vlerësimi i studentëve, sugjerimet për përmirësim dhe në arritshmërinë e objektivave të programit studimor.

Hapi 5: Në bazë të analizave dhe përfundimeve mund të propozohen ndryshimet e mundshme në programin e studimit. Raporti i rishikimit të programit studimor propozohet dhe mirëtohet në Këshillin e fakultetit, më së largu deri në fund të muajit Prill. Në rast të ndryshimit/plotësimit të programit, të njëjtat duhet të marrin miratimin e Senatit. Senati i Universitetit shqyrton dhe miraton ndryshimet e programit studimor, më së largu në fund të muajit Maj.

Hapi 6: Programi i studimeve me ndryshime, fillon të zbatohet me fillimin e vitit të ri akademik (1 Tetor).

Figura 1. Procesi i rishikimit të programeve studimore





4. PROCESI I AKREDITIMIT DHE RI-AKREDITIMIT

4.1. Aplikimi për programe të reja studimore

Universiteti ka pjesë Strategjike hartimin dhe miratimin e programeve të reja Studimore. Programet e reja studimore janë bazë e misionit në Universitet. Universiteti do t'u ofrojë mundësi studentëve të zgjedhin programe të përshtatshme studimore, të fitojnë njohuri akademike të transferueshme të cilat do të ndihmojnë në avancimin profesional dhe zhvillimin në karrierë. Universiteti harton programe të reja studimore në përputhje me standardet e AKA- së, Kornizën kombëtare të Kualifikimeve, Kornizën e Kualifikimit Evropian në Arsimin e Lartë. Ato janë të zhvilluara në harmoni me modele të krahasueshme të Universiteteve Evropiane dhe sistemit të Bolonjës.

4.2. Procedura e hartimit të programeve të reja

Aplikimi i programeve të reja studimore në UHHP bëhet duke u bazuar në Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë, sipas këtyre hapave:

Hapi 1: Propozimin për programe të reja studimore iniciohen nga Këshillat e njësive akademike (ose akterë të tjerë). Propozimi duhet të bëhet më së voni në muajin Mars, 8 muaj para afatit të aplikimit për akreditim.

Hapi 2: Këshilli i Fakultetit themelon grupin punues për të hartuar një plan të mirëfilltë të arsyeshmërisë (studimi i fizibilitetit) dhe në përputhje me objektivat e Planit Strategjik të Universitetit dhe Planin Strategjik të fakultetit. Arsyeshmëria e hapjes së një programi studimor, argumentohet përmes hartimit të studimit të arsyeshmërisë. Plani i detajuar duhet të paraqitet në Këshill të fakultetit jo më vonë se tre muaj nga themelimi i këtij grupi punues.

Studimi i arsyeshmërisë së programit të ri studimor duhet të përmbajë:

1. Studimin e kërkesës së tregut të punës;
2. Profilin e programit studimor;
3. Përshtatshmërinë me Planin Strategjik të Universitetit;
4. Përshtatshmërinë me strategjinë nacionale të arsimit të lartë;
5. Përshtatshmërinë me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK);
6. Përshtatshmërinë me trendet e arsimit evropian dhe botëror;
7. Bartësit e programeve studimore, sipas kërkesave të parashtruara në manualin e AKA-së për akreditim (Thirrjen akademike të bartësit, profilin e studimeve të bartësit, numrin e punimeve në fushën përkatëse të bartësit të indeksuara në



platformat Web of Science (koleksioni bërthamë SCIE, SSCI dhe AHCI) apo Scopus, (duke përfshirë revistat ose shtëpitë botuese të dyshimta).

Hapi 3: Këshilli i Fakultetit shqyrton planin e arsyeshmërisë. Studimi i arsyeshmërisë për programin e ri studimor miratohet fillimisht nga Këshilli i Fakultetit, ndërsa përfundimisht miratohet nga Senati i Universitetit dhe Këshilli Drejtues i Universiteti, pas verifikimit të përshtatshmërisë të programit të studimit.

Hapi 4: Pas marrjes së vendimit nga organet e lartpërmendura, në muajin Tetor bëhet aplikimi për programin e studimeve, në AKA. Po ashtu, pas miratimit të planit të arsyeshmërisë Këshilli i Fakultetit themelon një grup punues për hartimin e Raportit të vetëvlerësimit (RVV) për programin e ri të studimeve.

Hapi 4: Raporti i RVV- së hartohet duke u konsultuar me të gjithë palët e interesit të brendshme dhe të jashtme. Hartimi i raportit bëhet në bashkëpunim të vazhdueshëm me strukturat e cilësisë, ndërsa sektori për zhvillim akademik shërben si mbështetje administrative në këtë proces.

Hapi 5: Raporti hartohet dhe dorëzohet në koordinim dhe Zyrën për Sigurimin e Cilësisë sipas afateve dhe dinamikës të përcaktuar nga AKA- ja.

4.3. Procedura e aplikimit për riakreditim

Me rastin e ri-akreditimit të programeve studimore, procesi i rishikimit dhe hartimit të Raportit të RVV- së nis së paku 12 muaj para afatit të aplikimit për riakreditim.

Këshilli i njësisë akademike përkatëse, e themelon Komisionin për Hartimin e RVV-së. Komisioni në bashkëpunim me strukturat për sigurimin e cilësisë dhe sektorin për zhvillim akademik e harton RVV- në në konsultim të ngushtë me palët e interesit, të brendshme dhe të jashtme.

Gjatë hartimit të RVV-së duhet të merren parasysh dispozita e Nenit 16 të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë³ dhe Standardet e akreditimit të AKA- së.

Raporti hartohet dhe dorëzohet në Koordinim dhe Zyrën për Sigurimin e Cilësisë sipas afateve dhe dinamikës të përcaktuar nga AKA- ja.

³ Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren, Neni 16. (https://www.uni-prizren.com/wp-content/uploads/2023/01/Rregullorja-per-sigurimin-e-cilesise-2022_ALB.pdf).